

VENDIM
Nr. 287, datë 14.5.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA RESTAURIMI I
OBJEKTIT, MERKATO-QENDËR, TË BASHKISË SË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga restaurimi i objektit, Merkato-Qendër, të bashkisë së Beratit.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Beratit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen sipas masës së dhënë në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 32 (tridhjetë e dy) m² truall, në vlerën 1 888 800 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 888 800 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Beratit, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Beratit.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.
 7. Regjistrimi i ri i pasurisë për sipërfaqen 32 (tridhjetë e dy) m² truall të bëhet në favor të bashkisë së Beratit.
 8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Beratit.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TË DHËNA MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
 “PËR RESTAURIMIN E OBJEKTIT, MERKATO-QENDËR”, BASHKIA BERAT
 Zona kadastrale 8502

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe/m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Ferdi Dura	8/139	5	59 025	295 125	Vërtetim pronësie
2	Beniamin Dura	8/139	12	59 025	708 300	Vërtetim pronësie
3	Hajrulla Dura	8/139	5	59 025	295 125	Vërtetim pronësie
4	Nuredin Seitaj	8/139	10	59 025	590 250	Vërtetim pronësie
	Totali		32		1 888 800	